



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura e –III-

**KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI, ZHVILLIM
RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM HAPËSINOR**

Procesverbal Nr. 11
nga mbledhja e mbajtur më **13.5.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 13,00

Të pranishëm :

Lulzim Zeneli kryetar i Komisionit, Berat Luzha, Selvie Halimi, Hesel Cakolli , Myrvete Pantina, Ali Lajçi, Kosara Nikolić, Elheme Hetemi. Zef Morina, Zylfi Merxha.

Mungoi :

Ibrahim Selmanaj

Nga Sekretaria e Kuvendit : Bajram Badivuku, Lule Ymeri dhe Drita Çarkaxhiu.

Pjesëmarrësit tjerë : Nga MBPZHR Këshilltari i Ministrisë, dhe Shefki Zeqiri, nga MMPH Lirije Berisha dhe vëzhgues tjerë të rregullt.

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.
2. Projektligji për Shitjen e Banesave...,
3. Projektligji për Ushqimin,
4. Shqyrtimi i projektligjit të produkteve të Bimëve dhe
5. Të ndryshme

Procesverbali nga mbledhja e kaluar

Kryesuesi Lulzim Zeneli përshëndeti anëtarët e komisionit duke konstatuar miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar dhe duke kërkuar hartimin e kërkesës për kryesinë e Kuvendit për transkriptimin e mbledhjeve të këtij komisioni.

Projektligji për Shitjen e Banesave

Lulzim Zeneli lidhur me këtë projektligj kërkoi nga zyrtarët e MMPH sqarimin e kërkuar nga komisioni, përkatësisht arsyeshmërinë e formulës së propozuar lidhur me shitjen e banesave . **Lirije Berisha** i ofroi komisionit shembuj konkret për solucionet e mundshme për çmimin e një banese sipas çmimit bazë 100 euro. Pas shqyrtimit të mundësive të ndryshme për një çmim sa më real, komisioni me votim unanim nxori :

P Ë R F U N D I M

MIRATOHET koeficienti 0.027 si mesatare më e përshtatshme për çmimin e banesave sipas këtij ligji.

REKOMANDIMET (amendamentet e komisionit të përfshira me versionin e MMPH) dërgohen në procedurën e mëtejme parlamentare.

Shqyrtimi i projektligjit për produktet e bimëve

Lulzim Zeneli konstatoi se ministri Vehapi nuk prezanton por ai ka dërguar këshilltarin e tij për këtë takim, pastaj theksoi se komisioni ka formuar disa nëngrupe për shqyrtimin e projektligjeve që do ti ndihmojnë komisionit në shqyrtimin e tyre. Fillimisht ai ia dha fjalën **këshilltarit të Ministrit** i cili ritheksoi qëndrimet e MBPZHR lidhur me këtë projektligj se kemi të bëjmë me një projekt kualitativ dhe që është në harmoni me politikën në mandatin e bujqësisë. Shefki Zeqiri gjithashtu arsyetoi më detalisht këtë projekt fillimisht si përpjekje për plotësimin e ligjit për Pesticide, kurse më vonë si përpjekje për ligj të ri. Ata propozuan që ky projektligj të vazhdoi në shqyrtimin e komisionit deri te miratimi në leximin e dytë. **Elheme Hetemi** si anëtare e caktuar në grupin e deputetëve që shqyrtojnë vërejtjet në projektligje tha se kemi të bëjmë me një ligj përmbajtësor edhe pse me disa gabime teknike. Ajo elaboroi më detalisht rreth projektit sidomos rreth titullit e cila duhet të jetë unike në tërë tekstin e ligjit, mos të përdoret tepër (ose aspak) fjala “mund” ngase ligji obligon, të shikohet mundësia e masës preventive për fermerin tonë në rast të tejkalimit të dozës së lejuar sipas ligjit, emri i ministrisë të shënohet komplet si është etj. **Shefki Zeqiri** u pajtua me të gjitha këto vërejtje dhe të gjitha ato që do të jenë në funksion të përmirësimit të ligjit. Me sugjerimin e kryesuesit komisioni u pajtua që në mbledhjen e radhës (të martën më 20.5.2008) zyrtarët e ministrisë të sjellin ndryshimet me shkrim në bazë të vërejtjeve të Elheme Hetemit.

Projektligji për Ushqimin

Lulzim Zeneli njoftoi komisionin rreth qëndrimit të arritur nga Qeveria rreth vendit të agjencisë së ushqimit , e cila ka sugjeruar zyrën e kryeministrit, me çka u pajtua komisioni-nuk kishte kundërshtime, mirëpo në vazhdim komisioni gjatë shqyrtimit të amendamenteve nga legjislacioni i dytë hasi në dilema rreth strukturës së agjencisë se kush kujt i përgjigjet, kush çfarë roli ka dhe kush sa është përgjegjës (Bordi, Kryeshefi etj). **Blerim Vela** tha se anëtarët e komisionit duhet ti heqin dilemat duke shikuar në mënyrë tabelare kompetencat e secilit organ, pastaj të vendosin se kush çka mund të ketë kompetenca. **Berat Luzha** propozoi, ndërsa **Kryesuesi** u pajtua që të enjten komisioni të takohet dhe mundësisht ta përfundoj këtë projektligj , por që secili anëtarë deri në atë ditë duhet të lexojnë me kujdes amendamentet e propozuara (edhe ato të Komisionit të Shëndetësisë).

Të ndryshme

Berat Luzha rikujtoi komisionin se të premtën është në leximin e parë projektligji për ndryshimin e Ligjit për Pyje, ndaj pasi që parashihen ca ndryshime lidhur me kompetenca të komunave, ai sugjeroi që para seancës komisioni të marr qëndrim paraprak rreth këtij projektligji bashkë me ministrin Idriz Vehapi.

Komisioni u pajtua këtë takim të mbaj të enjten në orën 13,00 dhe kjo temë të jetë pika e parë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 14,35.

Bajram Badivuku
Admin. i Komisionit,

Kryetari i Komisionit,
Lulzim Zeneli